

L I G J
Nr.7894, datë 29.12.1994

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.989, DATË 20.12.1994 “PËR
MARRJEN E MASAVE PËR TË PËRBALLUAR GJENDJEN E RËNDË ENERGJETIKE NË
VEND”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet dekreti nr.989, datë 20.12.1994 “Për marrjen e masave për të përballuar gjendjen e rëndë energjetike në vend” me këto ndryshime:

1. Në nenin 2, në rreshtin e dytë në vend të fjalëve “e nevojave energjetike” vihen fjalët “e energjisë së nevojshme”.

2. Neni 3 riformulohet si vijon: “Organet e pushtetit lokal ngarkohen të sigurojnë vazhdimësinë e prodhimit në furrat e bukës dhe furnizimin normal të tregut. Në të kundërt, personat përgjegjës dënohen për kundravajtje administrative me gjobë deri në 100 000 lekë me vendim të Shtabit Qendror”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1002, datë 30.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha